

RAPORT BASHKIMI ME PËRTHITHJE I SHOQËRIVE:

ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION SHA

si Shoqëri Përthithëse

DHE A2 ENGINEERING SHPK

si Shoqëri Përthithur

Tiranë,

16/09/2022



1. DEKLARATA PARAPRAKE DHE QËLLIMI I BASHKIMIT.....	3
2.FORMA LIGJORE E BASHKIMIT DHE PËRSHKRIMI I PROCEDURËS SË BASHKIMIT	4
3. STRUKTURA E SHOQËRIVE TË PËRFSHIRA NË BASHKIM.....	
6 4. BILANCET NË MBYLLJE DHE BILANCI I CELJES SË BASHKIMIT ME PËRTHITJE.....	6
5. AKTIVET DHE PASIVET E TRANSFERUESHME.....	7
6.TË DREJTA TË VECANTA.....	8
7. KRIJIMI I KUSHTEVE PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE.....	8
8. EFEKTET MBI PUNËMARRËSIT.....	8
9. EFEKTET MBI ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË PËRTHITHËSE PAS PËRTHITHJES.....	8
10. EFEKTETE LIGJORE TË BASHKIMIT.....	9
11. LISTA E ANEKSEVE	




1. DEKLARATA PARAPRAKE DHE QËLLIMI I BASHKIMIT

Në datën **16 Shtator 2022**, Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve të ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION SHPK, vendosi fillimin e procesit të bashkimit me përthithje nëpërmjet kalimit të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë A2 ENGINEERING (Shoqëria e Përthithur) tek ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION (Shoqëria Përthithëse). Ky vendim i bashkëngjitet këtij raporti si Aneksi 1A.

Në datën **16 Shtator 2022**, me vendim të ortakut të vetëm të A2 ENGINEERING SHPK (“A2 ENGINEERING”), u vendos fillimi i procesit të bashkimit me përthithje nëpërmjet kalimit të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë A2 ENGINEERING tek ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION Ky vendim i bashkëngjitet këtij raporti si Aneksi 1B.

Në përputhje dhe zbatim të vendimeve të mësipërm, A2 ENGINEERING dhe ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION do të bashkohen nga ana ligjore dhe organizative. Për këtë qëllim, A2 ENGINEERING dhe ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION do të integrohen në një person juridik të vetëm. (“Bashkimi” ose “Bashkimi me Përthithje”).

Qëllimi i këtij bashkimi është zhvillimi i mëtejshëm i aktivitetit të ofruar, përmirësimi i shërbimit të klientëve, rritja e konkureshmërisë në treg, ulja e kostove dhe shfrytëzimi më efektiv i burimeve, forcimi i brandit në treg dhe si rezultat, rritja e të ardhurave dhe fitimit

Bashkimi do të krijojë një shoqëri me një bazë më të gjerë asetesh e një vlerë neto biznesi më të lartë e cila do të mundësojë një qëndrim dhe mbrojtje më të fortë ndaj risqeve të ndryshëm gjatë operimit në treg.

Me një portofol më të gjerë produktesh e klientësh, me një kontroll më të fortë të shpenzimeve administrative dhe për shkak të të gjithë elementëve të përmendur më sipër, shoqëria pas bashkimit do të gëzojë një kapacitet më të lartë se ai i dy shoqërive individualisht, ne përfitim te shoqërisë se konsoliduar, tregut dhe konsumatoreve.

Duke qënë se A2 ENGINEERING zotërohet 100% nga ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë, mbajtës i 1 (një) kuote, sukcesi i bashkimit nuk rrezikohet nga ndryshime kulturore, që në këtë rast nuk ekzistojnë, apo as nga perceptimi i klientelës.

Bashkimi konsiderohet në përfitim të shoqërive pjesë në bashkim, punonjësve dhe kreditorëve të tyre. Edhe pas bashkimit me përthithje, misioni dhe vizioni i Shoqërisë Përthithëse do të mbetet i njejtë perkundrejt shoqërisë ku operon: të qënit lider dhe inovator në tregun shqiptar jo vetem ne aspektin e shërbimeve që ofron por edhe si shoqëri me përgjegjesi te larte sociale dhe nje prej kontributoreve në zhvillimin ekonomik-social të vendit.

Periodha nga data e miratimit të projekt marrëveshjes së bashkimit (nënshkrimit të projekt marrëveshjes së bashkimit) deri në datën e regjistrimit të transaksionit të Bashkimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit do të jetë një periudhë tranzitore gjatë së cilës A2 ENGINEERING

dhe ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION do të marrin një sërë masash e do të plotësojnë disa kushte më qellim përmbushjen me sukses të Bashkimit me përthithje.

2. FORMA LIGJORE E BASHKIMIT DHE PËRSHKRIMI I PROCEDURËS SË BASHKIMIT

Bashkimi i shoqërive me përthithje nënkupton transferimin e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të nga Shoqëria e Përthithur tek Shoqëria Përthithëse. A2 ENGINEERING si Shoqëria e Përthithur dhe ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION si Shoqëria Përthithëse do të bashkohen përmes procedurës së Bashkimit me Përthithje.

Procedura që ndiqet për realizimin e bashkimit të shoqërive duhet të kalojë në dy faza kryesore procedurale, të cilat njoftohen dhe regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Faza e parë fillon me hartimin e një projektarrëveshje nga përfaqësuesit ligjorë të dy shoqërive. Kjo projektarrëveshje i bashkënjgitet këtij raporti si Aneksi 2.

Projektarrëveshja midis palëve duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) emrat e regjistruar dhe selitë e shoqërive, që marrin pjesë në Bashkim;
- b) pranimi i palëve për kalimin e pasurive të shoqërisë që përthithet, në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë përthithëse (nëse ka këmbim);
- c) raporti i këmbimit të aksioneve/kuotave dhe cdo shumë e pagueshme në para (nëse ka procedura të tilla);
- d) kushtet e ndarjes së aksioneve/kuotave në shoqërinë përthithëse (nëse ka të tilla);
- e) të drejtat, që rrjedhin nga aksionet/kuotat në shoqërinë përthithëse;
- f) të drejtat, që shoqëria përthithëse u zotëruarve të aksioneve, kuotave apo të drejtave të vecanta të shoqërive të përthithura apo cdo masë tjetër në favor të tyre (nëse ka të tilla);
- g) përparësitë e vecanta, që u jepen administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit, këshillit mbikëqyrës apo ekspertëve kontabël të autorizuar (nëse ka të tilla);
- h) pasojat që bashkimi do të ketë ndaj punëmarrësve e përfaqësuesve të tyre, si dhe masat e propozuara për to.

Projektarrëveshja është një kontratë, e cila përmban termat përfundimtare që u propozohen për nënshkrim aksionerëve/ortakëve të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim. Duke qënë se termat mund të jenë shumë teknikë dhe jo gjithmonë të thjeshta për t'u kuptuar, ligji detyron përfaqësuesit ligjorë të hartojnë këtë raport i cili zbërthen dhe shpjegon projektarrëveshjen e mësipërme në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për të gjithë aksionarët/ortakët e shoqërive ku përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike të bashkimit si dhe efektin e këtij bashkimi tek punëmarrësit. Me qëllim që aksionerët/ortakët të njihen me projektarrëveshjen si dhe impaktin e saj, është e nevojshme që projektarrëveshja të publikohet në faqen e internetit të shoqërive dhe të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit të paktën 1 (një) muaj para datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë së shoqërive pjesëve bashkimit që do të miratojnë projektarrëveshjen e bashkimit.

Publikimi duhet të përmbajë këto dokumenta:

1. projekt marrëveshjen;
2. raportin e hollësishëm të përfaqësuesve ligjorë mbi projekt marrëveshjen;
3. pasqyrat financiare dhe ato të ecursisë së veprimtarisë të shoqërive, nese ka për të paktën tre vitet e fundit;
4. raporti i ekspertit;

Faza e dytë është ajo e miratimit të projekt marrëveshjes së bashkimit në asambljetë e shoqërive në proces bashkimi. Asambljetë e shoqërive miratojnë projekt marrëveshjen në kushtet e kuorumit dhe shumicës së cilësuar të cilat në rastin konkret janë 100%. Pas miratimit të projekt marrëveshjes së bashkimit në asambljetë e shoqërive, njoftohen organet tatimore dhe të gjitha autoritetet përkatëse të cilat duhet të autorizojnë bashkimin, pas marrjes së autorizimit dhe kryerjes së njoftimit në autoritetet përkatëse si më lart, si dhe miratimit përfundimtar të projekt marrëveshjes së Bashkimit dhe këtij raport të Bashkimit nga asambljetë përkatëse të Shoqërive, do të njoftojnë bashkimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Vetëm pas këtij njoftimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit mund të vijohet me:

1. Transferimin tek shoqëria përthithëse e të gjithë asetëve dhe detyrimeve të shoqërisë së përthithur;
2. Ç'regjistrimin e shoqërisë së përthithur në Qendrën Kombëtare të Biznesit (pas regjistrimit të vendimit të asambleve në Qendren Kombëtare të Biznesit, shoqëria e përthithur konsiderohet e prishur). Kreditorët e Shoqërisë së Përthithur kanë të drejtë që brenda 6 muajsh nga publikimi i vendimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit të paraqesin me shkrim titullin dhe vlerën e pretendimeve dhe të kërkojnë garanci të mjaftueshme nga shoqëria përthithëse për kredite e tyre. Ligji konsideron garanci të mjaftueshme lëshimin e një deklarate me shkrim nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që marrin pjesë në Bashkim, ku pranohet se pasuritë e shoqërive do të administrohen në mënyre të vecuar deri në përmbushjen e detyrimeve të te gjithë kreditorëve. Nëse kjo garanci nuk jepet nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, kreditorët mund t'i kërkojnë gjykatës të urdhërojnë lëshimin e garancive të mjaftueshme apo anulimin e vendimit të bashkimit.

3. STRUKTURA E SHOQËRIVE TË PËRFSHIRA NË BASHKIM

Në datën e këtij raporti, A2 ENGINEERING është 100% në pronësi të ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION si ortak i vetëm zotërues i një kuote. Ky fakt lehtëson dhe përshpejton procesin e vendimarrjes lidhur me bashkimin me përthithje të shoqërive. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë Përthithëse nuk do të zmadhohet pas bashkimit dhe rrjedhimisht nuk do të ketë asnjë efekt në aksionet e Shoqërisë Përthithëse. Bazuar në sa më sipër, dhe duke qënë se Shoqëria e Përthithur zotërohet nga Shoqëria Përthithëse në cilësinë e Ortakut të Vetëm, nuk është e nevojshme përfshirja e raportit të këmbimit të kuotave të A2 ENGINEERING në aksione/kuota.

4. BILANCET NË MBYLLJE DHE BILANCI I CELJES SË BASHKIMIT ME PËRTHITJE

Bashkimi me përthithje do të bazohet në pasqyrat financiare të A2 ENGINEERING dhe ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION SH.A. të datës 31 Dhjetor 2021 ("Data e Fundit Kontabël").

Data e Ekzekutimit të Bashkimit do të jetë data e regjistrimit të bashkimit me përthithje të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Bilanci i Celjes së Shoqërisë Përthithëse do të bazohet në bilancin e konsoliduar të datës së Fundit Kontabël të të dy shoqërive përpara përthithjes dhe fillon në datë 1 Janar 2022. Cdo ndryshim,

saktësim dhe korrigjim i mundshëm i Bilancit të Celjes, i realizuar mes Datës së Fundit Kontabël dhe Datës së Ekzekutimit të Bashkimit me Përthithje duhet të raportohet dhe miratohet përkatësisht nga asamblatë e ortakëve dhe aksionerëve të të dy shoqërive.

5. AKTIVET DHE PASIVET E TRANSFERUESHME

Në bazë të nenit 215, pika 1 e ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, të gjitha aktivet dhe pasivet e Shoqërisë së Përthithur A2 ENGINEERING sipas Bilancit të Datës së Fundit Kontabël, do të transferohen tek shoqëria përthithëse ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION Aktivet dhe pasivet e transferuara janë ato që do të jenë përcaktuar në Bilancin Kontabël të Datës 21 Dhjetor 2021 si dhe cdo ndryshim i ndodhur në librat kontabël nga Data e Fundit Kontabël deri në Datën e Ekzekutimit të Bashkimit me Përthithje. Aktivet dhe pasivet përfshijnë cdo të drejtë dhe detyrim të njohur si të tillë në pasqyrat financiare, bazën e të dhënave të klientëve, listën e konflikteve apo proceseve gjyqësore të pazgjidhura në datën e ekzekutimit të mbylljes, dhe cdo marrëdhënie tjetër kontraktore.

Aktivt dhe detyrimet tatimore të A2 ENGINEERING sic rezultojnë në pasqyrat financiare së datës së fundit kontabël, do t’i transferohen ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION së bashku me të gjithë llojet e tjera të aktiveve dhe detyrimeve.

Me transferimin e aktiveve dhe të detyrimeve, ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION do të marrë në posedim të gjithë evidencat, librat kontabël, korrespondencat, regjistrimet, marrëveshjet dhe dokumenta të tjera të cilat provojnë ekzistencën e të drejtave dhe detyrimeve që transferohen. Vetëkuptohet se me transferimin e të gjithë të drejtave, aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë së përthithur tek shoqëria përthithëse, kjo e fundit do të gëzojë të drejtat për të ngritur pretendime ligjore për këto aktive si dhe do të ketë detyrimin për tu përgjigjur ndaj pretendimeve që mund të ngrenë palë të treta ndaj shoqërisë së përthithur.

Për transferimin e atyre detyrimeve për të cilat mund të nevojitet miratimi i një pale të tretë, do të merret paraprakisht ky miratim.

Për pasuritë e palujtshme, ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION do të bëjë regjistrimin pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Të drejtat dhe detyrimet e A2 ENGINEERING dhe ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION kundrejt njerëra-tjetrës do të shuhën në Bilancin e Celjes së Shoqërisë Përthithëse.

Marrëdhënie të caktuara kontraktuale të shoqërisë A2 ENGINEERING me palë të treta (të tilla si kontrata shërbimesh të ndryshme), nëse konstatohet së nuk do t’i shërbejnë Shoqërisë Përthithëse pas bashkimit me përthithje, mund të vendoset të zgjidhen para ose pas datës së regjistrimit të bashkimit me përthithje, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe parashikimet e këtyre kontratave për zgjidhjen e tyre

Të gjitha filialet e A2 ENGINEERING, apo dhe filiale të reja që kalojnë në pronësi të A2 ENGINEERING deri në realizimin e plotë të Bashkimit, në Datën e Ekzekutimit kalojnë në pronësi 100% të ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION.

6. TË DREJTA TË VECANTA/TË DREJTAT E AKSIONARËVE/ORTAKEVE PAS BASHKIMIT

Kuota e ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION janë të llojit të thjeshta. Rrjedhimisht, ortakët/aksionarët nuk gëzojnë të drejta të vecanta. Të drejtat e kuotave të Shoqërisë Përthithëse do të mbeten të pandryshuara pas bashkimit i cili nuk do të shoqërohet me rritje kapitali.

7. KRIJIMI I KUSHTEVE PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE

Në mënyrë që të garantohet vijimësia e suksesshme e aktivitetit të Shoqërisë A2 ENGINEERING brënda strukturës së Shoqërisë ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION para Datës së Ekzekutimit duhet të garantohen disa kushte sic është marrja e pëlqimit nga palët e treta me të cilat shoqëritë që marrin pjesë në bashkim janë në marrëdhënie kontraktore, ku parashikohet dhe detyrimi i njoftimit të palës tjetër kontraktore në rast riorganizimi/bashkimi të shoqërisë në fjalë. Kushte të tjera konsistojnë në realizimin e publikimeve dhe njoftimeve të nevojshme, si dhe marrja e autorizimeve pranë Autoriteteve Përkatese sic parashikohet më lart në këtë raport.

Para datës së regjistrimit të bashkimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, A2 ENGINEERING dhe ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION duhet të njoftojnë palët e treta për transaksionin e bashkimit, nëse dicka e tillë është e parashikuar në kontratat në fuqi me këto palë.

8. EFEKTET MBI PUNËMARRËSIT

Në datën e regjistrimit të bashkimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, të gjitha kontratat e punës në fuqi me punëmarrësit e A2 ENGINEERING do t'i transferohen Shoqërisë Përthithëse ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION (në përputhje me nenin 138 dhe 139 të Kodit të Punës). Shoqëria Përthithëse do të marrë përsipër të gjithë kontratat e punës të punëmarrësve të Shoqërisë së Përthithur dhe do të jetë përgjegjëse për cdo detyrim të pashlyer kundrejt tyre nga Shoqëria e Përthithur para datës së ekzekutimit.

9. EFEKTET MBI ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË PËRTHITHËSE PAS PËRTHITHJES

Bashkimi me përthithje nuk do të sjellë asnjë ndryshim në organet drejtuese të Shoqërisë Përthithëse ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION Në datën e ekzekutimit të bashkimit, anëtarët e organeve drejtuese të ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION do të konsiderohen si anëtarët e organeve të shoqërisë përthithëse që do të rezultojë pas bashkimit. Anëtarët e organeve të A2 ENGINEERING do të japin Dorëheqjen në Datën e Ekzekutimit.

10. EFEKTETE LIGJORE TË BASHKIMIT

Në përputhje me parashikimet në nenin 220, pika 3, e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, regjistrimi i bashkimit të shoqërive pjesë e bashkimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit sjell si pasojë:

a) kalimin tek Shoqëria Përthithëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të Shoqërisë së Përthithur. Ky transferim ka pasojë si për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, ashtu edhe për palët e treta;

b) që Shoqëria e Përthithur të pushojë së ekzistuari, dhe të c'regjistrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, pa kaluar në proces likuidimi. Vetëm Shoqëria Përthithëse ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION do të vazhdojë të ketë personalitet juridik.

Bashkimi nuk do të ketë efekte të tjera lidhur me kapitalin e Shoqërisë Përthithëse duke qënë se kjo e fundit zotëron 100% të kuotave në Shoqërinë e Përthithur. Për këtë arsye, nuk është i nevojshëm raporti i këmbimit të kuotave/aksioneve.

11. LISTA E ANEKSEVE

Aneksi 1A. Vendimi i asamblesë së Përgjithshme të Ortakut te vetem të ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION për autorizimin e fillimit të procedurës së bashkimit me përthithje.

Aneksi 1B Vendimi i Ortakut të Vetëm të shoqërisë A2 ENGINEERING për autorizimin e fillimit të procedurës së bashkimit me përthithje.

Aneksi 2 Projekt Marrëveshja e Bashkimit. Ky raport përgatitet nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse ne bashkim, konkretisht A2 ENGINEERING si Shoqeria e Perthithur dhe ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION si Shoqeria Perthithese në vijim të autorizimit sipas vendimit të Asambleve e Ortakeve të Shoqërive ne fjale, në gjuhën shqipe

A2 ENGINEERING SHPK

Përfaqësuar nga:

Administrator



ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION SHPK

Përfaqësuar nga:

Administrator

